



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	25/20
Nr. i fq. / Br. sh	-02-
Data: / Datum	15.01.2020
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 1 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 4 paragrafi 2, pika 2.4. nënpika 2.4.3, nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 15.01.2020 merr këtë:

V E N D I M
PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHPRONËSIM TË PRONAVE TË
PALUEJTSHME

Neni 1

Fillohet procedura e shpronësimit të pronave të paluejtshme të pronarëve privat/zotëruesve të interesit, për qëllim të interesit publik – realizimi i projektit për rregullimin e rrugës “Adnan Shyti” në Vushtrri, Komuna Vushtrri, për pjesën e parcelës kadastrale si në vijim:

- P-70202016-04078K-0, në sipërfaqe prej **250 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7817 m², ZK-Vushtrri, bashkëpronar në pjesë ideale 1/4 Bahri Imer Xhaferi, Smajl Imer Xhaferi, Xhemail Imer Xhaferi dhe Hetem Imer Xhaferi, nga fshati Doberllukë, Komuna Vushtrri.

Neni 2

Shpronësimi i pjesës të parcelës kadastrale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me kompensim, konform dispozitave të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Neni 3

Vlerësimin për kompensimin e shpronësimit e bën Zyra për Vlerësim të Pronës së pa Luajtshme pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.

Neni 4

Me këtë vendim të njoftohen Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe pronarët/zotëruesit e interesit të parcelave që do të shpronësohen.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga organi shpronësues.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri
Xhafer Tahiri

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRIN

02 Nr. / Br. 34/20

Nr. i fq. / Br. sf

Data: / Datum 16.01.2020

VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës më 16.01.2020, merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT

1. Themelohet komisioni për monitorim dhe mbikëqyrje të Marrëveshjes për Shërbimet Primare të Menaxhimit të Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 Islam Latifi kryesues i komisionit
 - 1.2 Mentor Jashari , anëtar
 - 1.3 Imer Cecelia , anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë monitorimin përkatësisht mbikëqyrjen e zbatimit të secilës marrëveshje në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe KRM "Unitetit " në Mitrovicë, për shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë si dhe paraqes raport për zbatimin e kësaj marrëveshje.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi ju dërgohet :

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë.

REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br. 35/20

Nr. i fq. / Br. st. _____

Data: / Datum 16.01.2020

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe në Kërkesë të Drejtores të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, dt. 14.01.2020, Kryetari i Komunës më 16.01.2020, merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT

1. Themelohet komisioni për shpalljen e sportistit të vitit 2019 në Komunën e Vushtrrisë.
2. Komisionin do ta përbëjnë nga një anëtar të secilit klub sportiv propozues të Komunës së Vushtrrisë. Ky komision do të përzgjedh sportistin/ten më meritore për të u shpallë sportist/te të vitit 2019, konform Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Dhënie të Dekorativave 01nr.88/15, datë 30.04.2015. Shpallja sportist/te e vitit do të konstatohet me procesverbal nga komisioni.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- DKRS
- anëtarëve të komisionit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRAN

02 Nr./Dr. 94/20

Nr. i fq./Br. sh.

Data: / Datum 31.01.2020

VUSHTRRI - VUÇITRAN



Republike e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë



Bazuar ne nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

Me qëllim vënies së rendit dhe rregullit sa i përket hyrje daljeve nga ana e palëve dhe zyrtarëve si dhe të rritjes së sigurisë në objektin e komunës, urdhërohen të gjithë zyrtarët komunal të respektojnë me përpikëri rregullat si në vijim:

1. Hyrja zyrtare nga sheshi "Hasan Prishtina" duhet të përdoret vetëm nga zyrtarët e komunës (nëpunësit e administratës komunale);
2. Hyrja kryesore shërben për qytetarët – palët, ndërsa hyrja ndihmëse shërben dhe përdoret nga operatorët ekonomik me rastin e furnizimit edhe nga personeli i komunës për bartjen e gjësendeve;
3. Kartelat identifikuese të zyrtarëve dhe kartelat tjera që shërbejnë për hapjen e dymve janë për përdorim individual dhe duhet të përdoret vetëm nga zyrtari të cilit i është dhënë. Të gjithë përdoruesit e kartelave janë përgjegjës për të gjitha veprimet që rrjedhin nga përdorimi i kartelave të tyre;
4. Obligohen zyrtarët që kanë vizita zyrtare të institucione shtetërore, zyra diplomatike apo organizatave tjera (USAID, OSBE, GIZ, KFOR etj.) që ti presin në katin përdhese apo të njoftojnë Qendrën e shërbimeve për qytetarë apo punëtorët e sigurimit që ti shoqërojnë në hapësirën zyrtare. Me rastin e përfundimit të vizitës, vizitorët duhet të përcillen deri në hapësirën që është për palë. Kjo rregull vlen edhe për rastet kur zhvillohen takime me qytetarë apo vizitorë tjerë në hapësirat zyrtare.
5. Pranimi i palëve bëhet përmes Qendrës të Shërbimit me Qytetarë (QSHQ) në përputhje me Udhëzimin administrativ Nr.2018/03 të nxjerrë nga Ministria për Administrim të Pushtetit Lokal për organizimin dhe funksionimin të qendrave për shërbim me qytetarë. Vizitorët që dëshirojnë të vizitojnë një drejtori apo shërbim duhet të përdorin sistemin e komunikimit në hyrjen kryesore të objektit të komunës në QSHQ duke lajmëruar vizitën e tyre;
6. Zyrtarët duhet t'i evitojnë vizitat e panevojshme nëpër hapësira jashtë vendit të tyre të punës përveç rasteve kur janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të punës;
7. Zyra e personelit është përgjegjës për kthimin e kartelave të hyrjes kur një punonjës përfundon punësimin në komunë. Zyra e personelit informon Shërbimin për TI me qëllim që të anulohet kartelën që të mos ketë qasje në sistem;
8. Mbikëqyrjen dhe zbatimin e kësaj urdhërese do ta bëjnë zyra e personelit;
9. Për mos respektimin e kësaj urdhërese do të merren masa disiplinore konform akteve normative në fuqi;
10. Shërbimi i TI-së nxjerr raport mujor me të cilën identifikohen lëvizjet e zyrtarëve brenda drejtorive – zyrave përkatëse dhe i dorëzohet zyrës së Kryetarit;
11. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit;
12. Urdhëresa të vendoset në vende të dukshme për zyrtarë dhe palë në objektin e komunës dhe të ju dërgohet në e-mail të gjithë zyrtarëve komunal.



Xhafer TAHIRI

Kryetar i Komunës